

STATUTI
I SHOQËRISË TREGTARE
“Albanian Botanicals” sh.p.k

Sot në datën 27.09.2023 bazuar në ligjin Nr. 9901 “Për Tregtarët dhe shoqëritë Tregtare” i ndryshuar dhe në ligj Nr.9723,datë03.05.2007 “Për regjistrimin e biznesit” i ndryshuar, themeluesi:

Arbër Hasani, i biri i Hajdar Hasani, i datëlindjes 25.09.1987, me numër personal të kartës së identitetit I70925062S lindur e banues në Elbasan, me zotësi të plotë juridike për të vepruar

Vendosi të krijojë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar, redaktoi dhe nënshkroi Statutin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar “Albanian Botanicals” sh.p.k më poshtë vijon:

Kreu I
THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA

Neni 1
Emri, Data e Themelimit dhe Themeluesit

1.1 Emri i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është “Albanian Botanicals” sh.p.k. (më poshtë e quajtur "Shoqëria") e cila është themeluar më datën 27.09.2023

1.2 Shoqëria “Albanian Botanicals” sh.p.k themelohet nga ortaku:

- Arbër Hasani, i biri i Hajdar Hasani, i datëlindjes 25.09.1987, me numër personal të kartës së identitetit I70925062S lindur e banues në Elbasan, me zotësi të plotë juridike për të vepruar
- Adresa Zyrtare e-mail i shoqërisë do të jetë adresa: albanianbotanicals@gmail.com
- Numri i Kontaktit të Shoqërisë do të jetë:+355 692091084
- Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij akti themelimi dhe statuti të shoqërisë që do të miratohet nga ortakët themelues.

Neni 2

Objekti i Veprimtarisë

Shoqëria ka për objekt të saj kryerjen e të gjitha aktiviteteve që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtrojë në bazë të legjislacionit shqiptar, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duke u fokusuar kryesisht në:

Grumbullim, përpunim, kultivim. Tregti dhe import-eksport me shumicë dhe pakicë i bimëve medicinale, fruta-perimeve, cajrave, erëzave, esencave etj,

Tregti, shpërndarje, distribucion të artikujve të ndryshëm ushqimorë dhe industrialë, transport për llogari të shoqërisë.

Për të realizuar objektin e aktivitetit të saj, Shoqëria mund të veprojë në Shqipëri dhe jashtë saj dhe të kryejë çdo aktivitet tjetër të lidhur, ndihmës me qëllim të përmbushë ose të jetë i dobishëm për përmbushjen e objektit të saj.

Neni 3

Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një afat të pacaktuar dhe mund të shpërbëhet në çdo kohë dhe për çfarëdo lloj shkakut të parashikuar nga legjislacioni shqiptar në fuqi.

Neni 4

Selia

- 4.1. Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Lagja Skënderbej, Rruga Mbretërore, Nr. Pasurie 23/412, ZK 8523, Elbasan.
- 4.2. Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë mbi transferimin e selisë së Shoqërisë në një adresë tjetër. Organi administrues i Shoqërisë mund të themelojë ose mbyllë degë dhe/ose zyra përfaqësimi, brenda apo jashtë Republikës së Shqipërisë.
- 4.3. Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon: albanianbotanicals@gmail.com . Me vendim asambleje adresa elektronike mund të ndryshojë dhe duhet patjetër të publikohet në regjistrin tregtar si regjistrim vullnetar.

Kreu II
KAPITALI I SHOQËRISË

Neni 5
Kapitali i Shoqërisë

- 5.1. Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100 000 (njëqind mijë) lekë,
 - 5.2. Ortaku zotëron një kuotë të vetme në shoqëri.
 - 5.3. Pjesmarrja e ortakëve në kapitali e shoqërisë është si më poshtë:
 - 5.4. Ortaku z. Arbër Hasani: zotërues i ____1 (një) ____kuote me vlerë 100.000 lekë, që përbën 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- Kontributi i ortakut themelues është në para.

Neni 6
Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

- 6.1. Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anët e kontributeve në natyrë nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.
- 6.2. Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.
- 6.3. Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendime në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit. Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 7

Mënyra e fitimit dhe kalimit të kuotave

- 7.1. Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
- a) Kontributit në kapitalin e shoqërisë;
 - b) Shit-blerjes;
 - c) trashëgimisë;
 - d) dhurimit;
 - e) çdo mënyre tjetërtë parashikuar me ligj.
- 7.2. Pjesë të kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, përsa nuk parashikohet ndryshe në statut.
- 7.3. Pjesë të kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme në rrugë trashëgimie.
- 7.4. Transferimi i kuotave i nenshtrohet miratimit paraprak të shoqërisë me vendim asambleje ortakësh.
- 7.5. Ortakët kanë të drejtën e parablerjes në çdo rast transferimi kuotash dhe mund të heqin dorë vetëm duke u shprehur me shkrim para noterit.

KREU III

ORGANET VENNDIMMARRËSE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimarrës

- 8.1. Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.
- 8.2. Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.
- 8.3. Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- d) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat“c”dhe“d”të kësaj pike;
- f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- m) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

- 8.4. Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
- 8.5. Administratori i shoqërisë nuk mund të veproj në si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
- 8.6. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

- 9.1. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.



- 9.2. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.
- 9.3. Për efekt të thirrjes sipas pikës 1 të këtij neni ortakët deklarojnë adresat e tyre të postës elektronike të vlefshme për komunikim në mbledhjen e parë të asamblese. Ky vendim ruhet pranë selisë së shoqërisë.

Neni 10

Kuorumi

- 10.1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 përqind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit 9901 datë 14.04.2008, i ndryshuar "Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.
- 10.2. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11
Marrja e vendimeve

- 11.1. Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- 11.2. Asambleja e përgjithshme vendos me shumicëne votave të ortakëve pjesëmarrës për çështje të tjera si:
- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
 - c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - d) përcaktimin e shpërblimeve;
 - e) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecucisë së veprimtarisë;
 - f) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedime të tjera ndaj administratorëve;
 - g) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë.
- 11.3. Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Neni 12
Përfshirja nga e drejta e votës

- 12.1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:
- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
 - b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
 - c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
 - d) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

- 12.2 Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 13

Administratorët

- 13.1. Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje: Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- 13.2. E drejta e përfaqësimit i përket administratorit të shoqërisë. Këtë kompetencë ai mund ta delegojë me anë të një prokure të posaçme dhe personave tjerë. Administratori e ushtron të drejtën e përfaqësimit në përputhje me kufizimet e kompetencave dhe tagrave të parashikuara në nenin 14 të këtij statuti dhe të nenev 12 dhe 13 të Ligjit 9901 datë 14.04.2008, i ndryshuar "Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"
- 13.3. Administrator i parë i shoqërisë, me një afat 5 vjeçar nga data e regjistrimit në QKB, është Z. Arbër Hasani me nr. Personal: I70925062S

Neni 14

Kompetencat e Administratorit/ëve dhe kufizimet e tagrave të përfaqësimit

- 14.1. Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:
- a) Kryejnë të gjitha veprimet e administrimit, të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
 - b) Përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
 - c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - d) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë

së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet përshpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente për para asamblesë së përgjithshme për miratim;

- e) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f) kryejnë regjistrime dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- g) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçëm e me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- h) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut

14.2. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi

KREU IV

TE TJERA

Neni 15

Baza Ligjore

15.1. Shoqëria "Albanian Botanicals" sh.p.k funksionon në zbatim të plotë të normave të Statutit dhe përsa është parashikuar në këtë Statut, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe veçanërisht të Ligjit 9901 datë 14.04.2008, i ndryshuar "Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

15.2. Për sa nuk parashikohet në këtë statut do të integrohet dhe do të zbatohen dispozitat e Ligjit 9901 datë 14.04.2008, i ndryshuar "Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", të Kodit Civil dhe të legjislacionit të veçantë në R. SH.

Neni 16
Hyrja në fuqi

Ky statut hyn në fuqi pas regjistrimit të tij pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Statuti u përpilua në katër kopje, për t'jua shpërndarë organeve kompetente dhe një kopje do të mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë “Albanian Botanicals” sh.p.k

Akt themelimi dhe statuti i shoqërisë u përpilua në katër kopje, për t'jua shpërndarë organeve kompetente dhe një kopje do të mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë “Albanian Botanicals” sh.p.k.

ORTAKU THEMELUES
“Albanian Botanicals” sh.p.k

Arbër Hasani

